



Udhëzimi 19

Shtator 2016

Prokurimi publik

Marrëveshjet kuadër

PËRMBAJTJA

- [Marrëveshjet kuadër sipas Direktivës](#)
- [Përshtatshmëria e marrëveshjes kuadër](#)
- [Shpallja e marrëveshjes kuadër](#)
- [Procedurat për prokurimin e një marrëveshjeje kuadër](#)
- [Caktimi i operatorëve ekonomikë të një marrëveshjeje kuadër me shumë furnizues](#)
- [Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër](#)
- [Çështjet që mbulohen nga një marrëveshje kuadër](#)
- [Shpallja fituese e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër](#)
- [Njoftimi dhe periudha e ankesave](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Hyrje

Një numër Shtetesh Anëtare, duke përfshirë edhe vendet nordike, Francën dhe në Mbretërinë e Bashkuar, kanë një traditë të gjatë të përdorimit të marrëveshjeve kuadër. Kjo metodë e blerjes ka përfshirë përgjithësisht shpalljen e mundësisë nga autoriteti (ose autoritetet) kontraktor që ka hyrë më pas në një kontratë ose marrëveshje tjetër me një ose më shumë operatorë ekonomikë për dhënien e punëve, mallrave ose shërbimeve gjatë një periudhe të caktuar.

Kur punët, furnizimet apo shërbimet sipas marrëveshjes kuadër publike janë të një lloji që i bën ato objekt të Direktivës së Sektorit Publik (Direktiva)¹, dhe vlera e përgjithshme e parashikuar e blerjeve që do të bëhen në bazë të se marrëveshjes kuadër e kalon pragun përkatës financiar të BE-së, atëherë marrëveshja kuadër shpallet më pas në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)*, dhe operatorëve ekonomikë u jepet marrëveshja kuadër duke përdorur një nga procedurat standarde të prokurimit të përcaktuara në Direktivë. Shih Udhëzimin nr. 5 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Të kuptuarit e kufijve monetarë të BE-së*.

Kur lind një kërkesë për punë, furnizime ose shërbime të llojit të mbuluar nga marrëveshja kuadër, atëherë autoriteti kontraktor, i cili është përfitues i asaj dhënie të marrëveshjes kuadër, mund të japë (mini-kontratë)² për të realizuar kërkesat e tij në bazë të marrëveshjes kuadër, pa pasur nevojë për të ndjekur një proces të mëtejshëm të tenderimit.

Një tipar i përbashkët i marrëveshjeve kuadër ka qenë mungesa e sigurisë absolute për shumën totale që do të prokurohet gjatë afatit të marrëveshjes kuadër. Prandaj, marrëveshja kuadër shpesh mundëson fleksibilitet për blerësit e autoritetit kontraktor që nuk janë në gjendje që të angazhohen në një nivel të caktuar të blerjes në fillim të marrëveshjes. Marrëveshjet kuadër mund të përfshijnë një ose më shumë autoritete kontraktore si blerës dhe një ose më shumë operatorë ekonomikë.

Marrëveshjet kuadër janë përdorur shpesh nga organet qendrore blerëse që veprojnë ose në emër të vet ose në emër të një numri të autoriteteve kontraktore. Shih Udhëzimin nr. 20 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Organet qendrore blerëse*.

Arsyja e mbështetjes së metodës së marrëveshjeve kuadër të blerjes është arritje e kursimeve si në koston e prokurimit ashtu edhe në kohën e shpenzuar në procesin e prokurimit. Vlen të përmendet se kursimet më të rëndësishme janë arritur zakonisht kur blerja me anë të përdorimit të marrëveshjes kuadër është kombinuar me blerjen e përqendruar dhe prokurimin elektronik. Shih Udhëzimin nr. 11 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Mjetet e prokurimit*, dhe Shih Udhëzimin nr. 19 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Marrëveshjet kuadër*.

Përpara Direktivës së Sektorit Publik 2004³ nuk ka pasur dispozita specifike në direktivat e prokurimit publik që mbulonin krijimin dhe funksionimin e marrëveshjeve kuadër. Shtetet Anëtare që përdornin këto metoda kanë qenë të mendimit se nuk ka pasur nevojë për dispozita të veçanta, pasi direktivat ekzistuese përmbanin dispozita të mjaftueshme. Megjithatë, ka pasur shqetësime në nivel të BE-së në lidhje me mënyrën sipas të cilës funksiononin disa marrëveshje kuadër, ndërkohë që mungesa e qartësisë dhe mungesa e dispozitave të veçanta do të thoshte se disa Shtete Anëtare lejonin përdorimin e marrëveshjeve kuadër, ndërsa të tjerët jo. Prandaj, Direktiva 2004 miratoi për herë të parë dispozitat në lidhje me marrëveshjet kuadër. Kjo qasje ka vazhduar edhe në Direktivën e re.

¹ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

² Procesi i dhënies së kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër referohet shpeshherë si "mini-kontrata" ose "dhënie e mini-kontratës" dhe kontratat e lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër quhen kontratat të llojit "mini-kontratë".

³ Direktiva 2004/18/EC mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, 31 mars 2004.

Marrëveshjet kuadër sipas Direktivës

Termi "kuadër" mund të përdoret për të përshkruar një numër marrëveshjesh tregtare dhe të prokurimit. Megjithatë, përkufizimi i "marrëveshjes kuadër" është dhënë në Direktivë, dhe është ky lloj i marrëveshjes kuadër që është fokusi i pjesës në vazhdim të këtij Udhëzimi.

Neni 33 i Direktivës parashikon mënyrën në të cilën mund të krijohen dhe të përdoren marrëveshjet kuadër. Shtetet Anëtare duhet t'i vënë marrëveshjet kuadër në dispozicion të autoriteteve kontraktore, gjë e cila tregon se transpozimi i dispozitave të Direktivës për marrëveshjet kuadër në të drejtën kombëtare është i detyrueshëm.

Marrëveshja kuadër përcaktohet në nenin 33 (1) të Direktivës si "një marrëveshje ndërmjet një ose më shumë autoriteteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është krijimi i kushteve që rregullojnë kontratat që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar, në veçanti në funksion të çmimit dhe, kur kërkohet, në funksion të sasisë së parashikuar".

Autoriteti kontraktor që krijon një marrëveshje kuadër e shpall marrëveshjen kuadër dhe fton operatorët ekonomikë për të aplikuar për t'u caktuar në marrëveshjen kuadër. Autoriteti kontraktor shpall marrëveshjen kuadër në *GZBE* dhe përdor një prej procedurave standarde të prokurimit të përcaktuara në Direktivë për përzgjedhjen dhe vlerësimin e ofertave. Pas pranimit dhe vlerësimit të informacionit të përzgjedhjes dhe ofertave, autoriteti kontraktor shpall fitues të marrëveshjes kuadër një ose më shumë operatorë ekonomikë. Autoriteti kontraktor dhe pjesëtarët e marrëveshjes kuadër hyjnë pastaj në një marrëveshje kuadër që rregullon mënyrën sipas së cilës do t'i jepen kontratat pjesëtarëve të marrëveshjes kuadër dhe kushtet që zbatohen ndaj asaj dhënie.

Një avantazh i madh i marrëveshjeve kuadër është se njoftimi i vetëm i kontratës publikohet në *GZBE* dhe realizohet një proces i vetëm i prokurimit të BE-së duke mbuluar si krijimin e marrëveshjes kuadër ashtu edhe dhënien e mëvonshme të kontratave të mbuluara nga marrëveshja kuadër.

Kontratat e dhëna në bazë të marrëveshjes kuadër mund t'u jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesëtarëve të marrëveshjes kuadër pa konkurrim të mëtejshëm ose duke përdorur një mini-konkurrim vetëm në mes të pjesëtarëve të marrëveshjes kuadër. Nuk kërkohet që të bëhet shpallje sërish në *GZBE*, dhe as nuk kërkohet që të kryhet një proces i plotë i prokurimit të BE-së për dhënien e kontratave sipas marrëveshjes kuadër. Ky është një avantazh i madh, pasi kjo përshpejton afatet e prokurimit dhe mund të rrisë efikasitetin dhe të zvogëlojë shpenzimet në mënyrë të konsiderueshme si për autoritetin kontraktore ashtu edhe për operatorët ekonomikë, në veçanti kur kombinohet me blerjen e përqendruar dhe prokurimin elektronik.

Shënim: Në disa shtete anëtare, autoritetet kontraktore janë të detyruara të përdorin marrëveshjen kuadër ekzistuese, nëse ka një të tillë që të mbulon prokurimin e parashikuar. Në Shtetet e tjera Anëtare nuk ka asnjë detyrim të tillë. Kjo është një çështje e së drejtës dhe e politikave lokale.

Marrëveshjet kuadër zakonisht krijohen për t'u përdorur nga më shumë se një autoritet kontraktor - ose nga një autoritet kryesor apo një autoritet kontraktor që vepron si organ qendror blerës. Në këtë rast, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e transparencës, autoriteti kontraktor, si palë në një marrëveshje kuadër, duhet të identifikohet qartë për këtë qëllim, në ftesën për konkurrim ose në ftesën për të konfirmuar interesin. Marrëveshjet kuadër përdoren ndoshta vetëm në mes të këtyre autoriteteve kontraktore që janë identifikuar në mënyrë të qartë dhe të atyre operatorëve ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kuadër. Kjo kërkesë është bërë e qartë në nenin 60 të Direktivës.

“...disa aspekte duhet të sqarohen, në mënyrë të veçantë aspekti që marrëveshjet kuadër nuk duhet të përdoren nga autoritetet kontraktore të cilat nuk janë identifikuar në to. Për këtë qëllim, autoritetet kontraktore që janë palë në një marrëveshje të veçantë kuadër duhet të tregohen në mënyrë të qartë që nga fillimi, ose me emër ose me mjete të tjera, të tilla si referenca për një kategori të caktuar autoritetesh kontraktore brenda një zone gjeografike të përkufizuar në mënyrë të qartë, kështu që autoritetet kontraktore në fjalë të mund të identifikohen lehtë dhe pa mëdyshje. Po kështu, marrëveshja kuadër nuk duhet të jetë e hapur për hyrjen e operatorëve të rinj ekonomikë, pasi ajo është lidhur. Kjo do të thotë, për shembull, se kur një organ qendror blerës përdor një regjistër të përgjithshëm të autoriteteve kontraktore ose të kategorive të tyre, të tilla si autoritetet lokale në një zonë të caktuar gjeografike, që kanë të drejtë t’i drejtohen për ndihmë marrëveshjeve kuadër që lidh organi qendror blerës, ato duhet ta bëjnë këtë në një mënyrë që e bën të mundur që të verifikohet jo vetëm identiteti i autoritetit kontraktor në fjalë, por edhe data nga e cila ata përfitojnë të drejtën për t’iu drejtuar për ndihmë marrëveshjes kuadër të lidhur nga organi qendror blerës, pasi ajo datë përcakton se cilën marrëveshje kuadër të veçantë ai autoritet kontraktor duhet të lejohet të përdorë.”

Përshtatshmëria e marrëveshjes kuadër

Marrëveshja kuadër mund të mos jetë e përshtatshme për të gjitha llojet e blerjes. Autoritetet kontraktore duhet të jenë të sigura se marrëveshja kuadër do të sigurojë një mjet të përshtatshëm, ekonomik dhe efikas të blerjes.

Përdorimi më i përshtatshëm i marrëveshjes kuadër publike është rasti kur autoriteti kontraktor ka një kërkesë të përsëritur për punë, shërbime ose furnizime, por ku sasi të sakta që do të jenë të nevojshme janë të panjohura.

Për të vlerësuar përshtatshmërinë e një marrëveshjeje kuadër, autoritetet kontraktore duhet të kuptojnë avantazhet dhe disavantazhet e marrëveshjeve kuadër, llojet e ndryshme të marrëveshjeve kuadër, mënyrën se si krijohen ato, dhe se si ato funksionojnë në praktikë.

Shembuj të marrëveshjeve kuadër:

- Një departament i vetëm i qeverisë hyn në një marrëveshje kuadër për materiale kancelarie me tre furnizues.
- Katër autoritetet fqinje lokale hyjnë në një marrëveshje kuadër me një operator ekonomik për mirëmbajtjen e rrugëve.
- Një organ qendror blerës, duke vepruar në emër të 10 organeve shëndetësore, hyn në një marrëveshje kuadër me katër ofrues për furnizimin e automjeteve të emergjencës.

Shpallja e marrëveshjes kuadër

Marrëveshja kuadër duhet të shpallet në *GZBE* duke publikuar njoftimin e kontratës ose, në rastin e autoriteteve nën-qendrore, duke publikuar Njoftimin Paraprak të Informacionit si një ftesë për konkurrim. Kërkesa për shpalljen në *GZBE* zbatohet kur vlera e përlogaritur - duke përjashtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) - e të gjitha blerjeve që do të bëhen në bazë të marrëveshjes kuadër kalon pragun përkatës monetar të BE-së për këtë lloj kontrate.

Njoftimi i kontratës ose Njoftimi Paraprak i Informacionit publikohet në fillim të procesit të krijimit të marrëveshjes kuadër. Përdoret formulari standard i *GZBE*-së për Njoftimin e Kontratës ose për Njoftimin Paraprak të Informacionit. Duhet të plotësohet një seksion kuadër në formularin standard të *GZBE*-së, përveç të gjitha pjesëve të tjera përkatëse. Shih Udhëzimin nr. 6 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Shpallja*.

Pasi marrëveshja kuadër krijohet, nuk ka më ndonjë kërkesë të mëtejshme për të bërë shpallje në GZBE para dhënies së një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër.

Procedurat për prokurimin e marrëveshjes kuadër

Neni 33 (1) parashikon se çdo njëra prej procedurave të parashikuara në Direktivë mund të përdoret për të siguruar një marrëveshje kuadër. Për më shumë informacion mbi procedurat e prokurimit, shih Udhëzimin nr. 10 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Procedurat e prokurimit publik*.

Dispozita të ndryshme zbatohen vetëm kur jepen kontrata sipas marrëveshjes kuadër. Këto dispozita janë specifike për marrëveshjet kuadër.

Shënim praktik

Edhe pse është e mundur që të përdoret çdo njëra nga pesë procedurat kryesore konkurruese për të prokuruar një marrëveshje kuadër, në praktikë përdoren më shpesh procedurat e hapura dhe të kufizuara. Arsyeja për këtë është se marrëveshjet kuadër janë përgjithësisht më të përshtatshme për prokurimin e drejtpërdrejtë të mallrave dhe blerjet jo komplekse, që do të thotë se procedurat e hapura dhe të kufizuara janë procedurat më të përshtatshme.

Është e rëndësishme për të kuptuar se marrëveshja kuadër nuk është një listë e operatorëve ekonomikë të përzgjedhur që janë të kualifikuar për të siguruar punë, furnizime apo shërbime e mbulohen nga marrëveshja kuadër. Kjo është më shumë se një listë. Në mënyrë që operatorëve ekonomikë t'u jepet marrëveshja kuadër, ata duhet t'i kenë ofertat të kualifikuara dhe të dorëzuara, të cilat janë vlerësuar nga autoritetet kontraktore. Janë këto oferta ato që ofrojnë bazën për dhënien e kontratave në të ardhmen sipas marrëveshjes kuadër. Kriteri për shpalljen e fituesit dhe për caktimin në marrëveshjen kuadër është dorëzimi i ofertës ekonomike më të favorshme. Për informacion të mëtejshëm mbi kriteret e dhënies së kontratës shih Udhëzimin nr. 8 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Vendosja e kriterëve të shpalljes së fituesit*.

Caktimi i operatorëve ekonomikë të një marrëveshjeje kuadër me shumë furnizues

Kur autoriteti kontraktor synon të caktojë më shumë se një operator ekonomik dhe krijon një marrëveshje kuadër "me shumë furnitorë", atëherë Direktiva nuk përcakton ndonjë numër minimal ose një maksimal të operatorëve ekonomikë.

Megjithatë, numri maksimal i propozuar i operatorëve ekonomikë të caktuar në marrëveshjen kuadër duhet të tregohet në Njoftimin e Kontratës në GZBE.

Shënim praktik

Edhe pse nuk ka asnjë kufizim ligjor për numrin e operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në një marrëveshje kuadër, duhet të merren parasysh disa çështje praktike. Për shembull, caktimi i një numri shumë të madh operatorësh ekonomikë mund të jetë një dekurajim për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, pasi pjesa e tyre e mundshme e biznesit që ata mund të përfitojnë nga marrëveshja kuadër mund të jetë mjaft e vogël.

Për më tepër, nëse përdoret procesi i mini-konkurimit (shih më poshtë), atëherë mund të jetë e nevojshme në këtë fazë të dytë që të ftohen të gjithë operatorët ekonomikë që janë anëtarë të marrëveshjes kuadër për të marrë pjesë në konkurrim. Përsëri, operatorët ekonomikë mund të mos jenë të gatshëm për të marrë pjesë nëse ka shumë prej tyre që janë pjesëtarë të marrëveshjes kuadër. I duhet kushtuar vëmendje edhe çështjes praktike të autoritetit kontraktor që drejton marrëveshjen kuadër për rritjen e shumës së administrimit të përfshirë.

Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë me kujdes tregun, kërkesat dhe burimet e tyre gjatë fazës përgatitore përpara se të vendosë për numrin e duhur të operatorëve ekonomikë për një marrëveshje kuadër të veçantë.

Pjesëmarrësit e rinj në një marrëveshje kuadër, pasi ajo është hartuar

Palët në marrëveshjen kuadër mbeten të pandryshuara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër. Autoritetet e reja kontraktore ose operatorët ekonomikë të rinj nuk mund të bëhen më pjesë e marrëveshjes kuadër pasi ajo është krijuar.

Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër

Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër publike në përgjithësi nuk mund të kalojë katër vjet ndërkohë që kjo kohëzgjatje mund të jetë edhe më e shkurtër. Direktiva parashikon se kohëzgjatja mund të kalojë katër vite vetëm "në raste të veçanta të justifikuara sipas rregullave, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër".

Neni 62 i Direktivës e sqaron këtë çështje si më poshtë:

"Raste të tilla, të cilat duhet të jenë të justifikuara sipas rregullave, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër, mund të lindin, për shembull, kur operatorët ekonomikë kanë nevojë për depozitim e pajisjeve, periudha e amortizimit e të cilave është më shumë se katër vjet dhe, të cilat duhet të jenë në dispozicion në çdo kohë gjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër."

Një kuptim i mirë i natyrës së tregut të veçantë dhe i blerjeve që do të bëhen është thelbësor kur vendoset për kohëzgjatjen e kontratës. Duhet bërë shqyrtim i kujdesshëm për të balancuar përfitimet e marrëveshjeve afatgjata - të tilla si kostot e reduktuara të prokurimit dhe procedurat më të shpejta të prokurimit - me efektet e mundshme duke kufizuar konkurrencën për një periudhë të caktuar. Për shembull, mund të jetë më e përshtatshme që të jepet një marrëveshje kuadër me afat më të shkurtër për furnizimin e llojeve të caktuara të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, ku ka ndryshime të shpejta teknologjike (që do të thotë se produktet vjetrohen shpejt) dhe hyrje të shpeshta të produkteve të reja në treg.

Çështjet që mbulojnë nga një marrëveshje kuadër

Përmbajtja e marrëveshjes kuadër nuk është specifikuar në Direktivë, edhe pse legjislacioni kombëtar mund ta mbulojë këtë çështje. Marrëveshja kuadër zakonisht do të përfshijë detajet e mëposhtme: palët në marrëveshjen kuadër; kohëzgjatja; objekti; afatet që zbatohen për kontratat e dhëna në bazë të marrëveshjes kuadër; mënyra në të cilën duhet të jepen kontratat duke përfshirë kriteret për dhënien e mini-kontratave ose organizimet për ("mini") konkurrime të mëtejshme dhe kriteret që do të zbatohen; si dhe kostot e tenderuara apo metodologjitë e llogaritjes së kostos për dhënien e kontratave në të ardhmen.

Dhënia e kontratave në bazë të marrëveshjes kuadër

Si jepen kontratat në bazë të marrëveshjes kuadër që është krijuar vetëm me një operator ekonomik (marrëveshja me një furnitor të vetëm)? Kur marrëveshja kuadër është një marrëveshje vetëm me një furnitor, atëherë Direktiva parashikon që kontratat duhet të jepen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Kjo dispozitë do të thotë se autoriteti kontraktor ia jep kontratën drejtpërdrejt operatorit ekonomik pa konkurrim të mëtejshëm. Autoriteti kontraktor mund të kontaktojë operatorin ekonomik që është palë në marrëveshjen kuadër me shkrim duke kërkuar që ai të plotësojë ofertat e tij sipas nevojës. Megjithatë, kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër nuk mund t'u bëhen ndryshime të konsiderueshme, dhe marrëveshja kuadër nuk duhet të përdoret në mënyrë të parregullt, ose në mënyrë të tillë që të pengojë, kufizojë ose të shtrembërojë konkurrencën.

Si shpallen fituese kontratat në bazë të një marrëveshjeje kuadër që është krijuar me më shumë se një operator ekonomik (marrëveshje me shumë furnitorë)? Kur marrëveshja është krijuar me më shumë se një operator ekonomik, atëherë autoriteti kontraktor ka mundësinë e zgjedhjes në mes të tri mënyrave të mëposhtme të dhënies së një kontrate:

- Opsioni 1: dhënia e kontratës direkt një operatori të caktuar ekonomik duke zbatuar termat dhe kushtet objektive të përcaktuara paraprakisht në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimin;
- Opsioni 2: rihapja e konkurrimin ndërmjet operatorëve ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kuadër duke ftuar për të marrë pjesë të gjithë operatorët ekonomikë palë në marrëveshjen kuadër që janë të aftë të kryejë kontratën ("mini-konkurrimi");
- Opsioni 3: dhënia e kontratës pjesërisht pa rihapjen e konkurrimin, në përputhje me Opsionin 1, dhe pjesërisht me rihapje të konkurrimin ndërmjet operatorëve ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kuadër, në përputhje me Opsionin 2.

Kur shpallin dhe krijojnë marrëveshjen kuadër me shumë furnitorë, autoritetet kontraktore duhet të tregojnë qartë se si duhet të jepet kontrata, dhe marrëveshja kuadër duhet të përfshijë dispozita në lidhje me mënyrën e procesit të dhënies së kontratës.

Opsioni 1 – Shpallja fitues e operatorit ekonomik pa konkurrim të mëtijshëm: Autoriteti kontraktor mund të përdorë opsionin e parë, kur të gjitha kushtet janë përcaktuar në marrëveshjen kuadër. Kur autoriteti kontraktor dëshiron të përdorë këtë opsion dhe t'i japë kontratën në mënyrë të drejtpërdrejtë njërit nga operatorët ekonomikë palë në marrëveshjen kuadër:

- Ai duhet ta bëjë këtë duke ndjekur termat dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër, e cila duhet të përcaktojë:
 - Të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve ose furnizimeve në fjalë;
 - Kushtet objektive për përcaktimin se cili prej operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshje, duhet të kryejë punët, shërbimet ose furnizimet në fjalë;
- Palët nuk mund të bëjë ndryshime thelbësore në asnjë rrethanë të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër;
- Shpallja e fituesit nuk duhet të bëhet në mënyrë të papërshtatshme, ose në një mënyrë të tillë që të pengojë, kufizojë ose shtrembërojnë konkurrencën.

Në praktikë, dhënia e kontratës mund të bëhet në disa mënyra, në varësi të kushteve të marrëveshjes kuadër. Për shembull, mund të përdoret renditja në mënyrë që (1) kontrata i ofrohet gjithmonë së pari operatorit ekonomik që renditet i pari; ose (2) dhënia e kontratave mund të bëhet me rrotacion ndërmjet operatorëve ekonomikë; ose (3) operatorëve ekonomikë mund t'u jepet një përqindje, për të cilën është rënë dakord në avancë, e vlerës totale ose e numrit të kontratave të dhëna në bazë të marrëveshjes kuadër. Duhet të tregohet kujdes për të garantuar se pavarësisht se cila metodë përdoret, ajo duhet të jetë transparente dhe të sigurojë trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kuadër.

Opsioni 2 – Shpallja e fituesit duke përdorur mini-konkurrimin: Autoriteti kontraktor mund të përdorë opsionin e dytë të mini-konkurrimin, kur nuk janë përcaktuar të gjitha kushtet në marrëveshjen kuadër. Kërkesa e përgjithshme është që procesi i mini-konkurrimin duhet të bazohet në të njëjtat kushte si ato që zbatohen për dhënien e marrëveshjes kuadër. Direktiva parashikon, megjithatë, se këto kushte mund të "formulohen më saktë" në procesin e mini-konkurrimin. Ajo gjithashtu lejon edhe kushte të tjera që përmenden në dokumentet e

prokurimit që do të përdoren për dhënien e marrëveshjes kuadër. Kjo dispozitë i nënshtrohet parimit se palët nuk mund të bëjnë ndryshime thelbësore në asnjë rrethanë të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Të gjithë operatorët ekonomikë palë në marrëveshjen kuadër që janë të aftë të zbatojnë kontratën, ftohen të marrin pjesë në konkurrim mbi këtë bazë për të siguruar trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe transparencë.

Neni 33 (5) përcakton kërkesat themelore për zhvillimin e mini-konkurimit:

- Autoriteti kontraktor duhet të konsultohet me operatorët ekonomikë që janë të aftë për të zbatuar kontratën.
- Autoriteti kontraktor duhet të informojë operatorët ekonomikë me shkrim për mini-konkurrimin.
- Kuadri kohor i përcaktuar për kthimin e ofertave duhet të jetë mjaft i gjatë në mënyrë që të bëjë të mundur që ofertat të dorëzohen për kontratën specifike duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si kompleksiteti i objektit të kontratës dhe kohën që kërkohet për të dorëzuar ofertat.
- Ofertat duhet të dorëzohen në formë të shkruar.
- Përmbajtja e ofertave duhet që të mbetet konfidenciale derisa të ketë skaduar afati i përcaktuar kohor për dorëzimin e tyre.
- Kontrata duhet t'i jepet ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterëve të dhënies së kontratës të përcaktuara në dokumentet e prokurimit të marrëveshjes kuadër.
- Çmimi nuk duhet të vendoset në mënyrë të papërshtatshme, ose në një mënyrë të tillë që të pengojë, kufizojë ose shtrembërojë konkurrencën.

Nuk ka afate kohore ligjore që janë të specifikuar dhe mënyra për të ftuar operatorët ekonomikë që të marrin pjesë dhe të dorëzojnë ofertat nuk është përcaktuar në mënyrë të detajuar, por kjo nuk do të thotë se procesi duhet të bëhet në një mënyrë të paqartë ose të pastrukturuar. Prosesi i shpalljes së fituesit duhet të kryhet në përputhje me parimet e së drejtës së përgjithshme dhe me parimet e Traktatit,⁴ duke përfshirë kërkesën për ta realizuar procesin në mënyrë transparente për të siguruar trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim. Kur organizohet një mini-konkurrim lejohet që përdoren ankandet elektronike.

Opsioni 3 – Shpallja e fituesit pjesërisht me rihapjen e konkurimit dhe pjesërisht pa rihapjen e konkurimit: Autoriteti kontraktor mund ta përdorë këtë opsion kur marrëveshja kuadër përcakton të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve ose furnizimeve në fjalë.

Dhënia e kontratave mund të kryhet pjesërisht në përputhje me Opsionin 1 (pa rihapjen e konkurimit) dhe pjesërisht në përputhje me Opsionin 2 (me rihapjen e konkurimit). Përdorimi i këtij opsioni duhet të përcaktohet në dokumentet e prokurimit të marrëveshjes kuadër.

Kur përdoret ky opsion, kriteret objektive që do të përdoren për të përcaktuar shpalljen e fituesit, d.m.th., me ose pa rihapjen e konkurimit, duhet të përcaktohen në dokumentet e prokurimit të marrëveshjes kuadër. Dokumentet e prokurimit duhet të specifikojnë se cilat kushte mund të jenë subjekt i rihapjes së konkurimit.

⁴ Traktati për Funkionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati".

Është e rëndësishme të theksohet se këto dispozita zbatohen edhe për çdo "lot" të marrëveshjes kuadër, për të cilën janë përcaktuar në marrëveshjen kuadër të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve ose furnizimeve në fjalë. Këto dispozita zbatohen pavarësisht nëse të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve ose furnizimeve në fjalë në bazë të loteve të tjera janë hedhur poshtë apo jo.

Përsëri, palët nuk mund të bëjnë ndryshime thelbësore në asnjë rrethanë të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër, dhe çmimi nuk duhet të vendoset në mënyrë të papërshtatshme, ose në një mënyrë të tillë që pengon, kufizon ose shtrembëron konkurrencën.

Njoftimi dhe periudha e ankesave

Autoriteti kontraktor i dhënies së kontratës duhet të respektojë kërkesat e zakonshme të njoftimit dhe të pritjes së ankesave, kur krijohet marrëveshja kuadër. Njoftimi standard për dhënie të kontratës duhet të publikohet në *GZBE*, kur vlera e parashikuar e përgjithshme e kontratave që do të jepen në bazë të marrëveshjes kuadër, kalon pragun përkatës financiar të BE-së. Shih gjithashtu Udhëzimin nr. 6 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Shpallja*.

Direktiva nuk parashikon asnjë detyrim për të publikuar njoftimin për dhënien e kontratës, kur kontrata është dhënë në bazë të një marrëveshjeje kuadër. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore duhet t'i grupojnë njoftimet e rezultateve të procedurave të prokurimit për kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër në bazë tremujore. Në këtë rast, autoritetet kontraktore duhet t'i dërgojnë njoftimet e grupuara brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori.

Kërkesat për të njoftuar dhe për të respektuar kërkesat e pritjes së ankesave kur kontrata jepet, ndryshojnë sipas legjislacionit kombëtar. Arsyja për këtë është se dispozitat në Direktivën e mjeteve juridike që mbulojnë këtë situatë, përmbajnë përjashtime, që do të thotë se është në dorën e çdo Shteti Anëtar që të vendosë nëse t'i miratojë këto përjashtime apo jo për. Shih Udhëzimin nr. 12 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Mjetet juridike*.

Shënim praktik – Menaxhimi i marrëveshjes kuadër

Autoritetet kontraktore që drejtojnë një marrëveshje kuadër, duhet ta drejtojnë dhe ta monitorojnë atë marrëveshje kuadër në mënyrë proaktive. Është e rëndësishme, për shembull, që autoritetet kontraktore të blejnë vetëm në kuadër të marrëveshjes kuadër siç është shpallur dhe që metoda e dhënies së kontratës të jetë në përputhje me marrëveshjen kuadër dhe dispozitat e Direktivës.

Kujdes gjithashtu duhet të tregohet edhe për të siguruar që marrëveshjet kuadër nuk krijohen në mënyrë të tillë që të shtrembërojë konkurrencën dhe të përdoren në mënyrë të papërshtatshme.

Shërbimet

Dispozitat e Direktivës së Shërbimeve⁵ mbi marrëveshjet kuadër janë shumë më pak të detajuara dhe përshkruese se dispozitat e Direktivës.

- Subjektet kontraktore nuk duhet të përdorin marrëveshje kuadër "të paligjshme ose në një mënyrë të tillë që pengojnë, kufizojnë ose të shtrembërojnë konkurrencën".
- Përkufizimi i marrëveshjes kuadër publike është në thelb i njëjtë si në Direktivë.
- Kohëzgjatja maksimale e marrëveshjes kuadër publike është tetë vjet, "përveç rasteve të veçanta të justifikuara, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër".
- Kontratat e bazuara në marrëveshje kuadër duhet të jepen në bazë të rregullave dhe kriterëve objektive, të cilat duhet të sigurojnë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kuadër.
- Subjektet kontraktore mund të përdorin mini-konkurrimin, por Direktiva e Shërbimeve nuk përfshin rregulla të hollësishme për organizimin e tyre. Mini-konkurrimet duhet gjithsesi të organizohen si më poshtë:
 - Mini-konkurrimi duhet të jetë ndërmjet operatorëve ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kuadër.
 - Subjekti kontraktor duhet të caktojë një afat kohor për mini-konkurrimin që të jetë mjaftueshmërisht i gjatë që të mundësojë dorëzimin e ofertave.
 - Dhënia e kontratës duhet të bëhet në bazë të kriterëve të dhënies të përcaktuara në specifikimet e marrëveshjes kuadër.

⁵ Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

Informacion i mëtejshëm

Botimet e SIGMA-s

Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli 4, Botimet e OECD-së, Paris.

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Shpallja*, Udhëzimi 6, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Organet qendrore blerëse*, Udhëzimi 20, Botimet e OECD-së, Paris.

U SIGMA (2016), *Marrëveshjet kuadër*, Udhëzimi 19, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Mjetet e prokurimit*, Udhëzimi 11, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Procedurat e prokurimit publik*, Udhëzimi 10, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Vendosja e kriterëve të shpalljes së fituesit*, Udhëzimi 8, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Të kuptuarit e kufijve financiarë të BE-së*, Udhëzimi 5, Botimet e OECD-së, Paris.

Burime të tjera

Komisioni Evropian (2005), *Relacion: Marrëveshjet kuadër – Direktiva klasike*, CC/2005/03 rev. 1, 14 korrik 2005, Bruksel.

<http://ec.europa.eu/geninfo/query/resultaction.jsp?QueryText=Explanatory+Note%3A+Framework+Agreements+%E2%80%93+Classic+Directive&sbtSearch=Search&swlang=en>